



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës – E Hapur - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përefekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI: “Furnizim dhe vendosje moketi për kopshtet e Bashkisë Vlore ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: Kodi CPV: Tapete -39532000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,083,333 (Dy milion e tetedhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke PA TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *"Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose te ofertave Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik"*.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël".

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:** Sipas shtojcës 9 të këtyre dokumenteve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të vlerës së fondit limit.Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/c e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur e fondit limit të kontratës është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet se "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) 40% te vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulet monetar;”

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për kestat e maturuara te vitit 2026 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 43 pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e vërtetimit të shlyerjes së taksave vendore është vendosur në funksion të verifikimit të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe fiskale nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Dokumentacioni i kërkuar i shërben Autoritetit Kontraktor për të garantuar që operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurë ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me legjislacionin fiskal dhe administrativ në fuqi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 30 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe neni 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj

është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2.Operatori ekonomik duhet të disponoje

- 1 (një) person përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e procesit të furnizimit dhe vendosjes së mokitit

-Minimumi 4 punonjes për vendosjen e mokitit. të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi **per muajin e fundit** të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **muajin** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për **muajin** e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi ligjor : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 5(pese) punonjes, për të paktën muajin e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 5/b, ku numri i punonjesve i kërkuar është në përputhje me permasat dhe specifikat e kontratës. Kërkesa për disponimin e një personi përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e procesit të furnizimit dhe vendosjes së mokitit, si dhe të minimumi 4 (katër) punonjësve të angazhuar për realizimin e vendosjes, është përcaktuar në përputhje me natyrën, objektin dhe kompleksitetin e kontratës. Ky kriter synon të verifikojë aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në përputhje me specifikimet teknike, afatet e përcaktuara dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Kërkesa është proporcionale me volumin e kontratës, pasi lidhet drejtpërdrejt me sipërfaqen e mokitit që do të furnizohet dhe vendoset, afatin e realizimit dhe proceset teknike që kërkohej gjatë ekzekutimit të saj. Përcaktimi i këtij kriteri nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garanton që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të disponojnë kapacitetet minimale njerëzore të nevojshme për përmbushjen me sukses të detyrimeve kontraktore, duke respektuar parimet e barazisë, transparencës dhe proporcionalitetit në procedurat e prokurimit publik

Argumentim teknik për kërkesën për personel

Duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin furnizimin, transportin, përgatitjen, prerjen sipas përmasave, vendosjen dhe përfundimin e mokitit në ambientet e çerdheve dhe kopshteve, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik të disponojë burimet njerëzore të përshtatshme për realizimin me cilësi dhe brenda afatit të përcaktuar të kontratës.

Sipërfaqja e parashikuar për furnizim dhe vendosje mokitit është **786 m²**, ndërsa afati i realizimit është **10 ditë**, çka kërkon një organizim efektiv të punës dhe angazhim të mjaftueshëm të fuqisë punëtore.

Kërkesa për disponimin e:

- **1 (një) përgjegjësi teknik**, i cili do të jetë përgjegjës për organizimin, koordinimin dhe kontrollin e procesit të vendosjes, verifikimin e zbatimit të specifikimeve teknike dhe cilësisë së punimeve;
- **minimumi 4 (katër) punonjës për vendosjen e mokitit**, të cilët do të angazhohen për realizimin e proceseve të matjes, prerjes, shtrimit, ngjitjes, realizimit të bashkimeve, përfundimeve dhe pastrimit të ambienteve,

është e nevojshme për garantimin e realizimit të objektit të kontratës brenda afatit të përcaktuar dhe sipas kërkesave teknike të Autoritetit Kontraktor.

Kjo kërkesë është proporcionale me volumin e punës dhe nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin që operatori ekonomik të ketë kapacitetet minimale njerëzore për ekzekutimin e kontratës me cilësinë e kërkuar.

2.3.3. Operatori ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e proceseve të furnizimit, transportit dhe vendosjes së mokitit, si më poshtë:

- të paktën 1 (një) automjet për transportin e materialeve në vendin e realizimit të kontratës;
- pajisje profesionale për prerjen dhe përshtatjen e mokitit sipas dimensioneve të ambienteve;
- rul profesional për shtrirjen dhe fiksimin korrekt të mokitit;
- vegla profesionale të nevojshme për instalimin, ngjitjen dhe realizimin e përfundimeve të mokitit.

Operatori ekonomik duhet të vërtetojë disponimin e këtyre mjeteve dhe pajisjeve nëpërmjet dokumentacionit përkatës të pronësisë, përdorimit ose marrjes me qira, sipas legjislacionit në fuqi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit

26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi ligjor : Kriteri i vendosur për disponimin mjeteve dhe pajisjeve perkatese, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 5/ç. Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë mjetet dhe pajisjet minimale të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar në funksion të verifikimit të kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi kontrata përfshin jo vetëm furnizimin e mokitit, por edhe proceset e transportit, prerjes, vendosjes dhe përfundimit të instalimit të tij. Për realizimin e këtyre proceseve kërkohet disponimi i pajisjeve të përshtatshme që garantojnë ekzekutimin e kontratës sipas kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Përcaktimi i këtyre kërkesave është në përputhje me parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe trajtimit të barabartë, pasi janë kërkuar vetëm mjetet dhe pajisjet minimale të nevojshme për realizimin e objektit të kontratës dhe jo kërkesa të panevojshme ose kufizuese për operatorët ekonomikë. Ky kriter synon të sigurojë që operatori ekonomik i shpallur fitues të ketë kapacitetet reale teknike për të realizuar kontratën në mënyrë cilësore, brenda afatit të përcaktuar dhe në përputhje me specifikimet teknike.

Argumentim teknik. Duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të kontratës, e cila përfshin jo vetëm furnizimin e mokitit, por edhe transportin, prerjen sipas dimensioneve të ambienteve, vendosjen, ngjitjen dhe realizimin e përfundimeve, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik të disponojë mjetet dhe pajisjet minimale teknike për realizimin korrekt të procesit të instalimit. Automjeti i transportit është i nevojshëm për sigurimin e lëvizjes dhe dorëzimit të materialeve në vendin e realizimit të kontratës, duke garantuar ruajtjen e cilësisë së produktit gjatë transportit. Pajisjet profesionale për prerjen e mokitit janë të domosdoshme për përshtatjen e materialit sipas përmasave reale të ambienteve dhe realizimin e prerjeve të sakta, duke shmangur dëmtimet dhe humbjet e panevojshme të materialit. Ruli profesional për shtrirjen e mokitit është i nevojshëm për eliminimin e rrudhave, flluskave dhe deformimeve gjatë vendosjes, duke garantuar një sipërfaqe të njëtrajtshme dhe një fiksime të qëndrueshme. Veglat profesionale për instalim janë të nevojshme për realizimin e proceseve të ngjitjes, bashkimeve, përfundimeve anësore dhe elementëve të tjerë të vendosjes, me qëllim garantimin e cilësisë estetike dhe funksionale të produktit të përfunduar. Kërkesa për këto mjete dhe pajisje është proporcionale me volumin dhe natyrën e kontratës, pasi lidhet drejtpërdrejt me proceset teknike të nevojshme për realizimin e furnizimit dhe vendosjes së mokitit dhe synon garantimin e ekzekutimit të kontratës sipas specifikimeve teknike dhe afatit të përcaktuar.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatë të vlefshme:

SSH EN ISO 9001 "Sisteme të menaxhimit të cilësisë", ose ekuivalente.

Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë nga një organizëm certifikues i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare dhe të jetë e vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. E nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë. Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës angazhohet se, në rast shpalljeje fitues dhe lidhjeje të kontratës, do të realizojë të gjitha proceset e nevojshme për ekzekutimin e plotë të objektit të prokurimit, duke përfshirë:

- matjen paraprake të ambienteve;
- transportin e materialeve në vendin e dorëzimit;
- prerjen e mokitit sipas dimensioneve reale të ambienteve;
- furnizimin dhe aplikimin e ngjithësisht profesional të përshtatshëm për vendosjen e mokitit, me emetime të ulëta;
- vendosjen dhe bashkimin e mokitit në mënyrë uniforme, pa diferenca në nivel;
- realizimin e përfundimeve dhe skajeve sipas kërkesave teknike;
- pastrimin e plotë të ambienteve pas përfundimit të punimeve;
- largimin dhe transportimin e mbetjeve të krijuara gjatë procesit të vendosjes, duke i dorëzuar ambientet në gjendje të pastër dhe të gatshme për përdorim.

Mosparaqitja e kësaj deklarate përbën mosplotësim të kërkesave të Dokumenteve të Tenderit.

1. Argumentimi ligjor. Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 8 ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë angazhimi për realizimin e të gjitha proceseve të nevojshme për ekzekutimin e plotë të objektit të prokurimit është përcaktuar me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe verifikimin e qasjes së operatorit ekonomik ndaj realizimit të objektit të kontratës. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin jo vetëm furnizimin e mokitit, por edhe proceset e lidhura me instalimin, përshtatjen dhe dorëzimin e ambienteve në gjendje të gatshme për përdorim. Kërkesa është proporcionale me objektin e kontratës, pasi përfshin vetëm angazhimet minimale të nevojshme për realizimin korrekt të furnizimit dhe vendosjes së mokitit dhe nuk vendos kufizime të pajustificuara ndaj operatorëve ekonomikë. Përcaktimi i këtij kriteri është bërë në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit në procedurat e prokurimit publik, duke synuar që operatori ekonomik fitues të ketë angazhimin dhe përgjegjësinë për realizimin e plotë të objektit sipas specifikimeve teknike, afateve dhe kushteve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. **Mosparaqitja e deklaratës konsiderohet mosplotësim i kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, pasi dokumenti shërben për të vërtetuar pranimin e detyrimeve teknike që rrjedhin nga objekti i kontratës.**

Argumentim teknik Duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të kontratës, e cila përfshin furnizimin dhe vendosjen e mokitit në ambientet e çerdheve dhe kopshteve, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik të angazhohet për realizimin e të gjitha proceseve teknike të nevojshme për përfundimin e plotë dhe funksional të objektit të prokurimit. Matja paraprake e ambienteve është e domosdoshme për përcaktimin e saktë të sipërfaqeve dhe dimensioneve, me qëllim shmangien e prerjeve të pasakta, humbjeve të materialit dhe garantimin e një shtrimi korrekt. Transporti i materialeve duhet të realizohet në mënyrë të përshtatshme për të garantuar ruajtjen e cilësisë dhe integritetit të mokitit deri në vendin e instalimit. Prerja e mokitit sipas dimensioneve reale të ambienteve është një proces teknik i domosdoshëm për përshtatjen e materialit me konfigurimin e hapësirave, duke siguruar përputhje të saktë me sipërfaqet dhe përfundime estetike. Përdorimi i ngjithësit profesional me karakteristika të përshtatshme dhe me emetime të ulëta është i nevojshëm për garantimin e fiksimit të qëndrueshëm të mokitit, duke marrë në konsideratë që objekti do të përdoret në ambiente ku qëndrojnë fëmijë dhe kërkohet siguri për cilësinë e ajrit të brendshëm. Vendosja dhe bashkimi i mokitit në mënyrë uniforme, pa diferenca në nivel, është e nevojshme për të garantuar sigurinë gjatë përdorimit, shmangien e pengesave në lëvizje, si dhe një rezultat të qëndrueshëm dhe estetik. Realizimi i përfundimeve dhe skajeve sipas kërkesave teknike është i nevojshëm për të siguruar mbylljen korrekte të sipërfaqeve, shmangien e dëmtimeve të skajeve dhe rritjen e jetëgjatësisë së produktit. Pastrimi i ambienteve pas përfundimit të vendosjes dhe largimi i mbetjeve të krijuara gjatë procesit janë pjesë e domosdoshme e dorëzimit të objektit në gjendje të përdorshme dhe të sigurt për fëmijët dhe stafin e institucioneve. Këto kërkesa janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e kontratës dhe synojnë garantimin e realizimit të plotë

të furnizimit me vendosje, duke siguruar cilësi, siguri dhe funksionalitet të produktit të dorëzuar.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun dhe/ose fletën teknike të prodhuesit për moketin e ofertuar.

Katalogu/Fleta teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të produktit objekt prokurimi, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë përputhshmërinë e tij me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Në katalogun/fletën teknike duhet të identifikohet qartë produkti i ofertuar (marka, modeli ose kodi i produktit, sipas rastit) dhe të evidentohen në mënyrë të qartë karakteristikat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, si trashësia, pesha, materiali përbërës, baza, klasa e përdorimit, klasa e reagimit ndaj zjarrit dhe çdo parametër tjetër teknik i kërkuar në specifikimet teknike.

Në rast se katalogu ose fleta teknike është në gjuhë të huaj, pjesët ku pasqyrohen karakteristikat teknike të produktit objekt prokurimi duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, në përputhje me kërkesat e Dokumenteve të Tenderit.

Katalogu/skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të artikullit objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në specifikimet teknike Në katalogun/et/skeda të paraqitur të shihen në mënyrë të dukshme lloji i moketit të ofruar, së bashku me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. (Pjesët specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e mallit që prokurohet nëq nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

Argumentimi ligjor. Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 6/b ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: *fotografite apo kataloget teknike; dhe/ose* Kërkesa për paraqitjen e katalogut dhe/ose fletës teknike të prodhuesit është përcaktuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi të verifikojë objektivisht përputhshmërinë e produktit të ofertuar me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi dokumentacioni teknik i produktit është i nevojshëm për të provuar karakteristikat dhe cilësitë e mallit që operatori ekonomik propozon të furnizojë dhe vendosë. Kërkesa është vendosur në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit në procedurat e prokurimit publik, pasi synon vetëm verifikimin e përmbushjes së kërkesave teknike dhe nuk përcakton një markë, prodhues apo model të caktuar. Përcaktimi i detyrimit për identifikimin e qartë të produktit të ofertuar dhe paraqitjen e karakteristikave teknike përkatëse garanton një proces vlerësimi të drejtë, të dokumentuar dhe të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Kërkesa për përkthimin dhe noterizimin e pjesëve përkatëse të dokumentacionit teknik, në rast se ato janë në gjuhë të huaj, është përcaktuar për të siguruar kuptueshmërinë dhe kontrollueshmërinë e informacionit të paraqitur gjatë procesit të vlerësimit. Ky kriter është proporcional me natyrën dhe rëndësinë e mallit që prokurohet, pasi lidhet me garantimin e cilësisë së produktit dhe mbrojtjen e interesit publik, duke siguruar që malli i furnizuar të jetë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Argumentim teknik Duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në furnizimin dhe vendosjen e moketit në ambientet e çerdheve dhe kopshteve, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme paraqitjen e katalogut dhe/ose fletës teknike të

prodhuesit, me qëllim verifikimin e karakteristikave reale të produktit të ofertuar. Mokedi është një produkt teknik, karakteristikat e të cilit ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe përshtatshmërinë e tij për përdorim në ambiente publike të frekuentuara nga fëmijët. Për këtë arsye, është e nevojshme që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi të verifikojë paraprakisht parametrat teknikë të produktit, si trashësia, pesha, materiali përbërës, lloji i bazës, klasa e përdorimit, karakteristikat e reagimit ndaj zjarrit dhe elementë të tjerë teknikë të kërkuar në specifikimet teknike. Katalogu/fleta teknike e prodhuesit përbën dokumentin teknik që pasqyron të dhënat dhe karakteristikat e produktit të ofruar dhe i mundëson Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të kryejë një vlerësim objektiv të përputhshmërisë së mallit me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Kërkesa për identifikimin e qartë të produktit të ofertuar (markë, model, kod produkti ose të dhëna të tjera identifikuese) është e nevojshme për të shmangur paqartësitë gjatë procesit të vlerësimit dhe për të garantuar që produkti i deklaruar në ofertë të jetë i njëjtë me produktin që do të furnizohet dhe instalohet. Kërkesa për përkthimin dhe noterizimin e pjesëve specifike të katalogut ose fletës teknike, kur dokumenti është në gjuhë të huaj, synon të sigurojë kuptueshmërinë dhe verifikueshmërinë e informacionit teknik nga Autoriteti Kontraktor, pa kërkuar përkthimin e plotë të dokumenteve që nuk kanë lidhje me karakteristikat e produktit të ofertuar. Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcionale me natyrën e mallit që prokurohet dhe synon garantimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së produktit sipas specifikimeve teknike të përcaktuara.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të garantojë cilësinë e mokedit të furnizuar dhe të punimeve të kryera për një periudhë minimale prej **24 (njëzet e katër) muajsh, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të objektit. Gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik është i detyruar, me shpenzimet e tij, të riparojë ose zëvendësojë çdo pjesë të produktit ose të punimeve që paraqet defekte, pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.**

Garancia duhet të mbulojë, të paktën:

- **deformimet ose ndryshimet e formës së mokedit;**
- **shkëputjen e mokedit nga sipërfaqja ku është vendosur;**
- **defektet e materialit;**
- **defektet që lidhen me vendosjen, ngjitjen, bashkimet dhe përfundimet;**
- **çdo mangësi që ndikon në funksionalitetin, qëndrueshmërinë ose përdorimin normal të mokedit dhe që nuk ka ardhur si pasojë e përdorimit të papërshtatshëm ose dëmtimeve të shkaktuara nga faktorë të jashtëm.**

Argumentimi ligjor Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 8 ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa që operatori ekonomik të garantojë cilësinë e mokedit të furnizuar dhe të punimeve të kryera për një periudhë minimale prej 24 (njëzet e katër) muajsh është përcaktuar me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe mbrojtjen e interesit të Autoritetit Kontraktor gjatë periudhës së përdorimit të produktit. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi kontrata përfshin jo vetëm furnizimin e mallit, por edhe procesin

e vendosjes së mokitit, i cili ndikon në funksionalitetin, qëndrueshmërinë dhe cilësinë përfundimtare të objektit të realizuar. Përcaktimi i një periudhe minimale garancie është një kërkesë e arsyeshme dhe proporcionale, pasi i jep Autoritetit Kontraktor sigurinë që produkti dhe procesi i instalimit do të jenë në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara dhe se çdo mangësi që lidhet me cilësinë e materialit ose realizimin e vendosjes do të korrigjohet nga operatori ekonomik pa kosto shtesë. Kërkesa nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin e cilësisë së furnizimit dhe përgjegjshmërisë së operatorit ekonomik për produktin e ofruar dhe shërbimet e lidhura me të, duke respektuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit në procedurat e prokurimit publik. Përcaktimi i elementeve që mbulohen nga garancia (deformimet, shkëputjet, defektet e materialit dhe të vendosjes) është i justifikuar, pasi këto janë mangësi që mund të ndikojnë në përdorimin normal, jetëgjatësinë dhe sigurinë e produktit dhe lidhen drejtpërdrejt me detyrimet që rrjedhin nga kontrata.

Argumentim teknik Duke marrë në konsideratë që objekti i kontratës konsiston në furnizimin dhe vendosjen e mokitit në ambientet e çerdheve dhe kopshteve, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme përcaktimin e një periudhe minimale garancie për të garantuar që produkti i furnizuar dhe procesi i instalimit të ruajnë karakteristikat teknike, funksionale dhe estetike gjatë përdorimit normal. Ambientet e çerdheve dhe kopshteve janë ambiente me përdorim të përditshëm dhe intensitet të lartë lëvizjeje, ku moki do të jetë subjekt i konsumimit, pastrimit të shpeshtë dhe ngarkesave të vazhdueshme mekanike. Për këtë arsye, kërkohet që materiali të ketë qëndrueshmëri të përshtatshme dhe që vendosja e tij të realizohet sipas kërkesave teknike. Garancia prej 24 muajsh është përcaktuar si një periudhë e arsyeshme për të evidentuar dhe korrigjuar defekte të mundshme që mund të lidhen me:

- cilësinë e materialit të mokitit;
- qëndrueshmërinë e strukturës dhe formës së produktit;
- cilësinë e ngjitjes dhe fiksimit në sipërfaqen e vendosjes;
- realizimin korrekt të bashkimeve dhe përfundimeve.

Mbulimi i deformimeve, shkëputjeve, defekteve të materialit dhe defekteve të instalimit është teknikisht i nevojshëm, pasi këto problematika ndikojnë drejtpërdrejt në jetëgjatësinë, sigurinë, pamjen estetike dhe funksionalitetin e mokitit. Kërkesa që operatori ekonomik të riparojë ose zëvendësojë me shpenzimet e veta elementët me defekt garanton që produkti i dorëzuar të ruajë parametrat e kërkuar teknikë gjatë periudhës së garancisë dhe mbron Autoritetin Kontraktor nga kostot shtesë që mund të lindin për shkak të mangësive të materialit ose të vendosjes. Ky kriter është përcaktuar duke marrë në konsideratë destinacionin e përdorimit të produktit, kushtet reale të shfrytëzimit dhe nevojën për garantimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së investimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë mbështetur në specifikimet teknike të realizuar në kontratën e ngjashme të vitit 2025 kontratë e realizuar me sukses , të paraqitur në shtojcën 6 të DST.*

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të

materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizojnë produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentim teknik dhe ligjor për përcaktimin e specifikimeve teknike

Specifikimet teknike për furnizimin dhe vendosjen e mokitit janë përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, destinacionin e përdorimit të produktit dhe nevojën për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe qëndrueshmërisë gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

Moketi do të vendoset në ambientet e çerdheve dhe kopshteve, të cilat janë ambiente publike me frekuentim të përditshëm nga fëmijët dhe personeli. Për këtë arsye, është e nevojshme që materiali i kërkuar të ketë karakteristika teknike që sigurojnë rezistencë ndaj konsumimit, mirëmbajtje të lehtë, siguri gjatë përdorimit dhe përshtatshmëri për ambiente të brendshme.

Kërkesat teknike të përcaktuara, si trashësia minimale, pesha totale, materiali përbërës, lloji i bazës, rezistenca ndaj konsumimit, vetitë antistatike, rezistenca ndaj njollave dhe karakteristikat e reagimit ndaj zjarrit, janë vendosur me qëllim që produkti i furnizuar të garantojë:

- qëndrueshmëri mekanike dhe jetëgjatësi në kushtet e përdorimit të përditshëm;
- ruajtjen e formës dhe pamjes estetike gjatë përdorimit;
- siguri për përdoruesit, veçanërisht për fëmijët;
- lehtësi në pastrim dhe mirëmbajtje;
- përshtatshmëri me kërkesat higjieno-sanitare të ambienteve ku do të përdoret.

Referimi ndaj standardeve teknike europiane ose ekuivalente, si EN 1307, EN 13501-1, EN ISO 9239-1 dhe EN 14041, është bërë me qëllim sigurimin e një niveli të përshtatshëm cilësie dhe performance të produktit, duke lejuar njëkohësisht paraqitjen e produkteve ekuivalente që plotësojnë të njëjtat nivele performance.

Përcaktimi i këtyre specifikimeve teknike është bërë në përputhje me parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, pasi kërkesat lidhen drejtpërdrejt me funksionin, përdorimin dhe performancën që duhet të sigurojë produkti dhe nuk synojnë favorizimin e një marke apo prodhuesi të caktuar.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë që të garantojnë përdorimin me efektivitet të fondeve publike, duke siguruar furnizimin me një produkt cilësor, të sigurt dhe të përshtatshëm për nevojat e Autoritetit Kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT